

Zehrije Plakolli

VETËDIJËSIMI I PRINDIT PËR ROLIN E TIJ NË SHKOLLË DHE NË SHOQËRI

Duke pasur parasysh ndryshimet që po zhvillohen brenda shoqërisë e familjes dhe duke vlerësuar rëndësinë e faktorit prind brenda këtij zhvillimi, shihet që është shumë e nevojshme çështja e pedagogjizimit të prindërit dhe “mobilizimit” të tij për përkushtim më të njëmendët e më adekuat ndaj fëmijës. Kjo është e nevojshme, sepse në ambientin tonë jetësor (në shkollë, rrugë dhe ambiente të ndryshme shoqërore...) reflektohet një shkallë shumë e ulët e qytetërimit dhe edukimit.

Qëllim fundamental i familjes shkollës dhe i shoqërisë në raport me fëmijën dihet që është formimi i një individi të suksesshëm e të dobishëm. Por, në mënyrë të veçantë, prindi, si faktor kyç, duhet të jetë mësues permanent, edukues dhe ndikues gjatë gjithë jetës së fëmijës, posaçërisht gjatë moshës së tij të hershme, e sidomos në rrethana të këtilla të tranzicionit.

Mund të duket i rëndë dhe i pakëndshëm për prindërit titulli i këtij trajtimi, por është i motivuar nga mungesa e aspektit të ndërtimit të personalitetit të drejtë e të dinjitetshëm të fëmijës-nxënësit, në familje dhe në shkollë. Si pasojë e kësaj, kemi shumë të theksuara mundësitë e dëmtimit dhe devijimit të personalitetit të fëmijës. Ky fakt shkakton pastaj një sistem problematikash në familje, në shkollë dhe në shoqëri përgjithësisht.

Prindi duhet të mbajë përgjegjësi për mbarëvajtjen e shkollës

Është konstatim edhe i psikologëve dhe i pedagogëve që mënyra më e mirë dhe më e fuqishme për edukimin e fëmijës është dashuria, kujdesi i prindit dhe koha që kalon ai në afërsi me të. Familja është burim i ideve dhe njohurive të para për jetën e botën. Prindi është faktori esencial, i cili ia plotëson fëmijës nevojat e zhvillimit fizik, psikik, moral, social dhe edukativ. Edukimin e fëmijës prindi duhet ta realizojë në kushte dhe në rrethana të natyrshme dhe spontane. Në favor të kësaj, ai duhet ta organizojë edhe kohën e lirë që ia kushton atij. Kështu që, prindi patjetër që duhet të përmbushë pjesën e tij edukative, me një përkushtim më të gjithanshëm, permanent, racional e të vullnetshëm, sepse është në pyetje fëmija i tij. Secili prind duhet të dijë se fëmija duhet edukuar në familje dhe jo t'i lihet vetëm shkollës ose të lihet të vetedukohet në mënyrë të pakontrolluar.

Duke u bazuar në gjendjen reale e faktike të mbarëvajtjes së shkollave tona, konstatohet që shumë problematika e kriza të shumanshme të shkollës, burimin e kanë te papërgjegjësia e nevojshme e prindit ndaj fëmijës së tij (nxënësit). Mospërkushtim dhe papërgjegjësi të duhur tregojnë shumë prindër (natyrisht jo të gjithë), të cilët janë më pak të emancipuar dhe nuk kanë shumë kapacitet të njohurive, në mënyrë që të kuptojnë rëndësinë e interesimit më të gjithanshëm ndaj fëmijës. (...përveç plotësimit të nevojave elementare; sigurimit të vendstrehimit, ushqimit, veshmbathjes dhe pajisjeve të duhura për shkollim, duke menduar që me edukim të fëmijës duhet të merret vetëm shkolla).

Por, qasja jo e duhur ndaj fëmijës vërehet edhe nga ana e shumë prindërve të cilët janë më të shkolluar-emancipuar. Një pjesë e tyre primare e kanë punën dhe karrierën e vet, kurse fëmijëve prindin ua kompensojnë me institucionet e ndryshme që merren me fëmijë,

ose me kujdestare të zgjedhura pa ndonjë kriter. Një pjesë tjetër e prindërve edhe atë kujdes që e tregojnë për fëmijën, e bëjnë në mënyrë të paqëlluar, joadekuate (ua bëjnë qefin atyre edhe në dëshirat më të skajshme, e këtë e bëjnë në emër të respektimit të trendit të kohës-modës dhe duke e bërë këtë, tolerojnë edhe gjëra që janë larg dobisë dhe larg etikës së nxënësit). Kështu, as këta prindër, të cilët mendojnë se bëjnë shumë për fëmijën, nuk e bëjnë të duhurën, nuk krijojnë afërsi shpirtërore, emocionale me fëmijët, nuk përpiqen t'ua japin atyre edukimin më të pazëvendësueshëm e më të dinjitetshëm që duhet dhënë prindi i njëmendët, fëmijës së tij.

Në mungesë të **vetëdijes** së shumë prindërve, që fëmija edukatën fundamentale duhet ta marrë nga ai, edukimi i fëmijës i lihet barrë vetëm shkollës. Kurse shkollat tona, janë përplot mangësi për edukim. Por, edhe po të mos ishin të tilla, nuk do të mund ta kompenzonin edukimin që duhet ta bëjë familja-prindi. Dhe, duke qenë kështu, fëmija mbetet shpirtërisht më i zbrazët, më i largët me të gjithë; edhe me prindërit, edhe me shkollën, edhe me shoqërinë, sepse ai fëmijë që nuk përjeton në shtëpi ngrohtësi e afërsi, ai nuk di ta krijojë atë as jashtë shtëpisë, me shoqëri, në shkollë e kudo tjetër. Si pasojë e kësaj, atij i mundësohet më shumë që të krijohet si një njeri me natyrë të ftohtë, indiferente, edhe të painteresuar sa duhet për dijen-shkollën e perspektivën e tij. Shpesh ndodh që këta fëmijë të jenë edhe të ashpër, të dhunshëm e të vrazhdë ndaj shokëve dhe shkatërrues e demolues ndaj ambientit jetësor e shkollor, në veçanti.

Të tillë nxënës, fatkeqësisht, ka plot në shkollat tona të fshatit dhe të qytetit, por shkollat e këtyre të fundit, akoma më shumë. E, fëmijët e shkollave të qytetit, zakonisht, janë të prindërve të shkolluar e intelektualë, por që shumë nga këta nuk gjejnë kohë as mundësi të merren me fëmijët e tyre, të cilët kanë tepër nevojë t'i ndiejnë afër prindërit dhe të ndihen më të sigurt e më të vlefshëm në familje dhe shoqëri. Për mosinteresimin e nevojshëm të këtyre prindërve

intelektualë, që sjell pasoja të natyrave më të ndryshme, ankohen mësuesit e shumë-shumë shkollave.

Prindërit e kujdesshëm, indirekt kontribuojnë shkollën

Familja është “shkolla” e parë e mësimit, e krijimit dhe përjetimit të ndjenjave morale e sociale të fëmijës, të cilat atij i nguliten për tërë jetën, sepse në gjirin e saj (familjes) ai e kalon pjesën më të madhe të kohës. Kështu që, prindi, duke pasur rol psikologjik, shpirtëror, etik e pedagogjik te fëmija, ndikon gjithanshëm në formimin e personalitetit të tij. Ai, përmes fëmijës-nxënësit, reflekton gjithanshëm edhe në shkollë dhe (zakonisht) shkollës nuk i paraqesin problem fëmijët e prindërve që kanë qasje të mirëfilltë dhe edukative ndaj fëmijës së tij - nxënësit, dhe të cilët:

- *Komunikojnë afërsisht, gjithanshëm e lirshëm me fëmijët;*
- *Kujdesen edhe për formimin shpirtëror-etik të fëmijës së vet;*
- *Diskutojnë me fëmijët për shkollën dhe gjithçka rreth saj;*
- *Kujdesen sa dhe çka shikon fëmija në TV, në internet...;*
- *Kujdesen sa rri fëmija jashtë shtëpisë, ku dhe me kë rri;*
- *Kujdesen edhe për ushqimin e fëmijëve, kur, ku dhe çka ha ai (duke e ditur që ushqyeshmeria adekuate është faktor edhe në mësimnxënie më efektive);*
- *Gjejnë kohë të kontaktojnë me shkollën, në vazhdimësi.*

Me këto “mbikëqyrje” nuk duhet nënkuptuar që fëmijës t’i ndërhyjmë imponueshëm në lirinë e tij, por në këtë mënyrë ndikohet pozitivisht në personalitetin e tij, akoma të paformësuar, dhe kështu fuqizohen ndikimet më të shëndosha e më edukative në fëmijën e njëkohësisht zvogëlohet mundësia e ndikimeve negative nga plot faktorë të tjerë të pakontrolluar (nga rrethi, shoqëria, rruga, TV...).

Janë tepër të rralla rastet që të devijojë në shkollë ose në shoqëri. Fëmija i një prindi vigjilent e të afërt me fëmijët, duke e ofruar atë, e ka më të lehtë edhe ta këshillojë dhe ta edukojë. Prindi i këtillë di t'i krijojë fëmijës atmosferën e dashur dhe të përshtatshme në shtëpi. Di ta mësojë fëmijën të kënaqet, të gjejë qetësi e ngrohtësi në familje dhe të mos ketë shumë zbrazësi për t'i plotësuar ato me zgjedhjet më të këqija, si: qëndrimi i tepërt jashtë shtëpisë, duhani, pijet narkotike, grindjet e ndryshme, si pasojë e shoqërimit të gabueshëm, etj. E krejt këto, padyshim, kanë përfundim të keq e ndonjëherë edhe tragjik.

Për papërgjegjësitë e prindërve, fëmijët janë të pafajshëm dhe krejtësisht të paaftë ta ndryshojnë këtë. Me këtë çështje duhet të merret shoqëria, njerëzit kompetentë për punë të tilla. (MASHT-i me të gjithë partnerët e tij, të cilët interesohen për edukimin e shoqërisë, e në mënyrë të veçantë Drejtoritë Komunale të Arsimit, të cilat, varësisht nga niveli i kulturës dhe i edukimit të prindërve, duhet të zhvillojnë aktivitete të nevojshme lidhur me ndërgjegjësimin dhe pedagogjizimin e tyre, në raport me fëmijën e tij dhe shkollën, sepse edhe sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar, pika 17.2, kjo ingerencë i lihet DKA-së).

Përpjekja e parë duhet bërë duke i ndihmuar shkollat për një qasje më të efektshme ndaj faktorit prind (sepse nëpër shumë shkolla prezenca e prindërve është tepër formale. Ata janë prezentë në shkollë vetëm formalisht, zakonisht vetëm në mbledhjet tradicionale-rutinore, 2-3 herë në vit, sa për të mbushur rubrikat administrativo-statistikore, të cilat gjinden në ditar të klasës). Të ndihmohet shkolla në përpilimin e planeve e projekteve, përmes të cilave ajo do të kërkojë përgjegjësi të gjithanshme ndaj prindit. Të kërkohej që bashkëpunimi i tij (prindit) me shkollën të mos jetë spontan, i paqëllimshëm dhe formal, por një bashkëpunim i përgjegjshëm, bashkëveprues, vendimmarrës dhe efektiv për mbarëvajtje të fëmijës e të shkollës.

Edhe në vendet më të zhvilluara, ku niveli i edukimit është shumë më i lartë se te ne, e ku shkolla dhe puna në të është shumë më e kënaqshme, prindërit janë faktorë shumë të rëndësishëm dhe partnerë shumë të rregullt në shkollë. Dhe, janë të tillë, edhe pse kanë lidhje të drejtpërdrejtë edhe përmes ueb-sajteve, ku prindërit i marrin informatat detale për fëmijët e tyre, në vazhdimësi. Këtë e bëjnë, duke e ditur që prindi është një ndër faktorët kryesor që ndikon në suksesin e fëmijës dhe të punës së shkollës, që në fakt bëhet për të.

Te ne ka pak prindër që e dinë se për edukimin e fëmijëve të tyre është e nevojshme një përgatitje e posaçme, sepse edukimi prindëror-familjar është më i fuqishmi dhe, varësisht nga ky, fëmija pëson ose përfiton për më tutje. Po ashtu, pak prindër e kuptojnë se çështja e edukimit të fëmijës është tepër delikate dhe e vështirë, prandaj për këtë, shkolla si partner i përbashkët me prindin, në dobi të fëmijës, duhet të insistojë që të trajtohet me seriozitet çështja e pedagogjizimit të tyre. E këtë ta bëjë me njerëz kompetentë, arsimorë, të cilët mund të angazhojnë resorë të ndryshëm profesionalë: sociologë, psikologë, pedagogë, mjekë dhe ekspertë të ndryshëm, në mënyrë që të ndikojë në ngritjen e përgjegjësisë së prindërve në raport me fëmijën dhe shkollën. Në kuadër të kësaj problematike, të iniciojë organizim të ndonjë ligjërate të kësaj natyre nëpër shkolla, ndonjë emision këshillues-pedagogjik për prindër në TV, ndonjë fushatë lidhur me këtë, etj. Qëllimi i krejt këtyre është vetëdijesimi i prindërve për seriozitetin që nënkupton **kujdesi adekuat** ndaj fëmijës dhe njëkohësisht të theksohen pasojat e pakujdesisë ose papërgjegjësisë së tyre, e që janë rreziqet permanente që të rinjtë të degjenerohen në shumë aspekte dhe në këtë mënyrë, spontanisht, edhe shoqëria përgjithësisht.

Përgjegjësia e duhur e prindërit ndaj fëmijës nuk do të thotë heqje e përgjegjësisë së shkollës ndaj tij

Natyrisht, për gjithçka lidhur me nxënësin (suksesin, sjelljen, vijueshmërinë, veshjen...) nuk duhet hequr përgjegjësinë nga shkolla e t'i lihet ajo vetëm prindit. Duhet obliguar gjithsesi personelin e shkollës të angazhohet me gjithë këtë kompleksitet gjërash, lidhur me nxënësin, sepse dihet *që kuptimi i punës së shkollës është zhvillimi shpirtëror, moral, kulturor e intelektual i nxënësit.*

Prindi dhe shkolla janë faktorë që e plotësojnë njëri-tjetrin në formimin e personalitetit të fëmijës. Mangësitë e cilitdo nga këta dy faktorë lënë zbrazëti të pakompensuar në zhvillimin e fëmijës në një perspektivë të dyfishtë, **individuale dhe shoqërore.**

Nevoja e shtrimit të kësaj çështjeje është e bazuar në fakte reale të situatës nëpër shkollat tona.

1. Mësimi është jociësor, edhe pse çdo aktivitet arsimor e ka për qëllim këtë, (testet kombëtare me vjet s' e mbërrijnë as 45% të pikëve të duhura, e kjo d.m.th mësimdhënia-nxënia është më shumë formale sesa efektive, e që në këtë mossukses patjetër që fajtoje nuk është vetëm shkolla).

2. Mungesë e disiplinës së përgjithshme, në shumicën shkollave tona, (kjo është reflektuar në gjithçka që lidhet me shkollën: sukses, vijueshmëri, braktisje, injorim, shkatërrim e abuzim të shkollës, në dhunë, brutalitet e arrogancë, në raport me mësues dhe ndërmjet nxënësve, deri në konflikte edhe tragjike, e plot defekte të tjera të pranishme në shkolla).

Koordinimi i kujdesit të dyanshëm, **i shkollës dhe prindit,** për fëmijën mundëson zhvillime pozitive në mënyrë të gjithanshme në shkollë. Pastaj, ndikon shumë pozitivisht edhe në familje, ku krijohet afërsia më e madhe në raportin prind-fëmijë, mundësohet funksionim më i shëndoshë i familjes dhe shtohet njëkohësisht dinjiteti i prindit

dhe i fëmijës. E këta, dihet, janë esenciale për funksionim të një shoqërie më të dinjitetshme.

P.S.

Ky trajtim i shkurtër është bërë për ta sensibilizuar domosdoshmërinë e qasjes më edukative të prindërve ndaj fëmijëve dhe faktorizimin e prindit në raport me shkollën, me në fokus fëmijën, sepse **pjesa më e mirë e njerëzimit janë fëmijët**, prandaj qasja adekuate ndaj tyre përcakton shumëçka për një shoqëri.

Vetëdijesimi i prindit dhe komunitetit për rëndësinë e edukimit të fëmijës është pikë e veçantë e definuar në masën 4.3.1, të Strategjisë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë, 2007-2017, por kjo pikë akoma nuk është bërë objektive e ndonjë aktiviteti të rëndësishëm shoqëror.